



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.258/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, për shkak të vendosjes në shtyll elektrike të posterave të kandidatit për Kuvend Komunal në komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohen** si të bazuara ankesat ZL. Anr. 258/2017, dhe ZL. Anr. 259/2017 të datës 19.10.2017 e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL. Anr. 258/2017, dhe ZL. Anr. 259/2017 të datës 19.10.2017 dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL. Anr. 258/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të dy ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Me datën 19.10.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankesa nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren me të cilën pretendon se subjekti politik LVV dega në Prizren, në fshatin Lubizhd ka vendosur në shtyll elektrike materjalin propagandues të kandidatit për kuvend komunal në Prizren Lulzim Morina. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastet në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 20.10.2017, subjekti politik LVV, thekson se kandidati Lulzim Morina pa dijenin e qendres se LVV-së ka vendosur këto postere, dhe se për kete LVV ka ndërmarr masat permisuese konform nenit 32.6 të LZP-së duke i larguar fotot nga lokacioni i caktuar

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se:

## **Ankesat janë të bazuara**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidat të subjektit politik LVV janë vendosur në shtyll elektrike gjegjësisht në objekt publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve dhe slloganeve, në objekte publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LVV, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit nga ky subjekt politik, janë vendosur në objekt publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastin: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se LVV, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marr subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e tij ka njoftuar se ka marr masa permisuese dhe se ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi, se dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli gjat vendosjes mori parasysh edhe faktin se subjekti politik LVV ka bërë përpjekje serioze të përcaktuar me nenin 32 par.6 pikat a), b), c), d),e) të LZP-së, për ti parandaluar parregullësit që po shkaktohen nga simpatizantët apo mbështetësit e subjektit në fjalë, dhe ky veprim i subjekti në fjal nga paneli është vlerësuar pozitivisht dhe ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

ZL. Anr.258/2017 më datën 20.10.2017.



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*